

20240521291

Në bazë të nenit 38 paragrafi 2 të Ligjit për arsimin e mesëm (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/ 03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/ 11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/ 16, 67/17 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 229/20) dhe neni 20 paragrafi 3 nga Ligji për arsim profesional dhe trajnim (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/06, 117/ 08, 148/09, 17/11, 24/13, 137/13, 41/14, 145/15, 55/16 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 275/19), ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN E DHËNIES DHE VLERËSIMIT TË REZULTATEVE TË NXËNËSVE NË PROVIMET E MATURËS SHTETËRORE NË GJIMNAZE, ARSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIMIN E MESËM TË ARTEVE

Neni 1

Në Rregulloren për mënyrën e dhënies dhe vlerësimit të rezultateve të nxënësve në provimet shtetërore të maturës në gjimnaze, arsimin profesional dhe arsimin e mesëm të arteve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 66/10, 63/12 dhe 159/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 65/21 dhe 85/23), në nenin 10 në paragrafin 4 pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët „përveç në rastet kur masën e anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit.”

Neni 2

Në nenin 26 paragrafi 6 ndryshohet dhe thotë:

„Gjatë kohës së provimit, kandidati mund të braktisë ambientin e provimit vetëm në rast të një problemi shëndetësor sipas vlerësimit të testuesit, së bashku me një nga testuesit rezervë.”

Neni 3

Nenet 46, 47, 48 dhe 49 ndryshohen dhe thonë:

„Neni 46

Kandidati që shkel rregullat për dhënien e provimeve të maturës shtetërore mund të paralajmërohet gjatë provimit, të përjashtohet nga provimi, t’i anulohet provimi dhe t’i anulohet provimi me ndalim për dhënien e provimeve në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit.

Me shkelje e rregullave nga paragrafi 1 i këtij neni, nënkuptohet:

- posedimi dhe përdorimi i materialit të palejuar në ambientin e provimit (letër, telefon celular dhe pajisje të tjera elektronike);

- sjellje e papërshtatshme gjatë provimit (kur kandidati tenton të ndërpresë provimin, kur një kandidat i krijon pengesa një kandidat tjetër ose kur kandidati kërcënon testuesit ose vëzhguesit e provimit);

- shkëmbimi i informacioneve në lidhje me provimin;

- kopjimi nga një kandidat tjetër;

- dhënia e provimit në vend të një kandidat tjetër;

- mosdorëzimi i të gjithë ose një pjese të materialit të provimit (testi dhe/ose lista e përgjigjeve);

- lejim i përdorimit të punimit të tij nga një kandidat tjetër;

- shkrimi i shenjave ose përmbajtjeve (të pahijshme) në test ose në listën e përgjigjeve që nuk kanë lidhje me provimin dhe
- e shkruan identitetin e kandidatit në ndonjë pjesë të testit.

Neni 47

Për shkeljen e rregullave të dhënies së provimeve eksterne të maturës shtetërore, të bëra nga ana e kandidatit, shqiptohen masat vijuese të cilat janë të shkallëzuara:

- paralajmërim gjatë provimit;
- ndërprerja e provimit (përrjashtim nga provimi);
- anulimi i provimit dhe
- anulimi i provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit.

Masa e paralajmërim gjatë provimit, shqiptohet në rastet kur kandidati flet vetëm një herë gjatë provimit, vërtitet ose përpiket të vendosë kontakte me kandidatët e tjerë.

Masa e ndërprerjes së provimit (përrjashtim nga provimi), shqiptohet në rastet kur kandidati sillet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (kur kandidati tenton të ndërpresë provimin, kur njëri kandidat i krijon pengesa ose e ndihmon një kandidat tjetër).

Testuesi/vëzhguesi masat e shqiptuara nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni i regjistron në Formularin për identifikimin e kandidatëve - Protokoll.

Përgjigjet e kandidatit në test vlerësohen deri në shqiptimin e masës ndërprerje e provimit (përrjashtim nga provimi).

Masa e anulimit të provimit, shqiptohet në rastet kur kandidati gjatë provimit:

- posedon mjete të palejuara që nuk janë të parapara me programin e provimit (letër, telefon celular ose pajisje të tjera elektronike);
- shkëmben informacione në lidhje me provimin me një kandidat tjetër ose testues;
- kopjon nga një kandidat tjetër;
- lejon që punimin e tij ta shfrytëzojë një kandidat tjetër ose
- nuk e dorëzon të gjithë materialin e provimit (testin dhe/ose listën e përgjigjeve).

Testuesi/vëzhguesi masën e shqiptuar nga paragrafi 6 i këtij neni e evidenton në Formularin për identifikimit të kandidatëve - Protokoll.

Masa e anulimit të provimit, shqiptohet në procesin e vlerësimit kur vlerësuesi i provimit ekstern konstaton se në test:

- kandidati ka shkruar emrin dhe mbiemrin e tij (ose ka zbuluar identitetin e vet);
- ka përgjigje identike për pyetjet eseistike me të paktën një kandidat tjetër ose
- është zbuluar plagjiaturë në përgjigjet e pyetjeve eseistike nga burime të specifikuara.

Vlerësuesi evidenton shkeljet e rregullave për dhënien e provimeve të maturës shtetërore nga paragrafi 8 i këtij neni, në Formularin për evidentimin e parregullsive nga ana e kandidatit.

Përgjigjet e kandidatit gjatë shqiptimit të masës së anulimit të provimit vlerësohen me zero pikë për të gjithë testin.

Masa e anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit, shqiptohet në rastet kur kandidati:

- jep provimin në vend të një kandidat tjetër (zëvendësimi i identitetit) ose
- sillet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (kur kandidati kërcënon një kandidat tjetër ose testues ose vëzhgues të provimit).

Përgjigjet e kandidatit gjatë shqiptimit të masës së anulimit të provimit me ndalim për dhënien e provimeve të maturës shtetërore në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit, vlerësohen me zero pikë në të gjithë testin për atë provim për të cilin është shqiptuar masa dhe kandidatit i ndalohet t'i nënshtrohet provimeve të tjera në të njëjtin afat provimi, si dhe i ndalohet dhënia e provimeve të maturës shtetërore në afatin e ardhshëm të provimit.

Testuesi/vëzhguesi masën e shqiptuar nga paragrafi 11 i këtij neni, e evidenton në Formularin për identifikimit e kandidatëve - Protokoll.

Testuesi/vëzhguesi i evidenton shkeljet e rregullave për dhënien e provimeve të maturës shtetërore në Formularin për identifikimit e kandidatëve – Protokoll.

Propozim për shqiptimin e masës së anulimit të provimit me ndalim për dhënien e provimeve të maturës shtetërore në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit, japin testuesi dhe vëzhguesi përmes KSHM-së deri te QSHP-ja.

Komisioni për shqiptimin e masave pranë QSHP-së, jo më vonë se publikimi i rezultateve preliminare të provimeve eksterne nga provimi i maturës shtetërore, me shkrim e njofton KSHM-në për kandidatin për të cilin është shqiptuar masa nga paragrafi 11 i këtij neni.

Neni 48

Për shkelje të rregullave të dhënies së provimeve të interne të maturës shtetërore, të bëra nga ana e kandidatit, shqiptohen këto masa, të cilat janë të shkallëzuara:

- paralajmërim gjatë provimit;
- ndërprerja e provimit (përrjashtim nga provimi);
- anulimi i provimit dhe
- anulimi i provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit.

Masa e paralajmërimit gjatë provimit, shqiptohet në rastet kur kandidati flet vetëm një herë gjatë provimit, vërtitet ose përpqet të vendosë kontakte me kandidatët e tjerë.

Masa e ndërprerjes së provimit (përrjashtim nga provimi), me propozim të testuesit, shqiptohet nga KSHM-ja, në rastet kur kandidati sillet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (kur kandidati tenton të ndërpresë provimin ose kur një kandidat i krijon pengesa një kandidat tjetër).

Përgjigjet e kandidatit në test vlerësohen derisa të shpallet përfundimi i provimit (përrjashtim nga provimi).

Masën e anulimit të provimit, me propozimin e testuesit e shqipton KSHM-ja në rastet kur kandidati gjatë provimit:

- posedon mjete të palejuara që nuk janë të parapara me programin e provimit (letër, telefon celular ose pajisje të tjera elektronike);
- shkëmben informacione në lidhje me provimin me një kandidat tjetër ose testues;
- kopjon nga një kandidat tjetër;
- lejon që punimi i tij të përdoret nga një kandidat tjetër ose
- nuk e dorëzon të gjithë materialin e provimit.

Masa e anulimit të provimit me propozim të vlerësuesit shqiptohet nga KSHM-ja, në rastet kur vlerësuesi i provimit konstaton se në test:

- kandidati ka shkruar emrin dhe mbiemrin (ose ka zbuluar identitetin e tij);
- ka përgjigje identike për pyetjet eseistike me të paktën një kandidat tjetër ose
- është zbuluar plagjiaturë në përgjigjet e pyetjeve eseistike nga burimet e specifikuara.

Përgjigjet e kandidatit në test vlerësohen derisa të shqiptohet masa ndërprerje e provimit (përrjashtimi nga provimi).

Masën e anulimit të provimit me ndalim për dhënien e provimeve të maturës shtetërore në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit e shqipton KSHM-ja me propozim të testuesit në rastet kur kandidati:

- jep provimin në vend të një kandidat tjetër (zëvendësimi i identitetit) ose
- sillet në mënyrë të papërshtatshme gjatë provimit (kur kandidati kërcënon një kandidat tjetër ose testues ose vëzhgues të provimit).

Përgjigjet e kandidatit kur shqiptohet masa e anulimit të provimit me ndalim të dhënies së provimeve të maturës shtetërore në të njëjtin dhe në afatin e ardhshëm të provimit vlerësohen me zero pikë në të gjithë testin për atë provim për të cilin është shqiptuar masa. shpallet dhe kandidatit i ndalohet t'i japë provimet e mbetura në të njëjtin afat provimi, si dhe i ndalohet dhënia e provimeve të maturës shtetërore në afatin e ardhshëm të provimit.

Neni 49

Nëse vëzhguesi konstaton se testuesi nuk vepron në përputhje me nenin 47 të kësaj rregulloreje, ose e ndihmon kandidatin në zgjidhjen e testit, ai e përjashton testuesin nga ambienti i provimit dhe e zëvendëson me një nga testuesit rezervë.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, vëzhguesi e informon Kryetarin e KSHM-së dhe QSHP-në për ndryshimin e bërë dhe e evidenton në Formularin për vëzhgimin e maturës shtetërore.

Vëzhguesi për rastet nga paragrafi 1 të këtij neni, përgatit një raport dhe ia dorëzon QSHP-së, jo më vonë se një ditë pas zhvillimit të provimit ekstern të maturës shtetërore.

QSHP-ja raportin nga paragrafi 3 i këtij neni, ia dorëzon punëdhënësit të testuesit, jo më vonë se publikimi i rezultateve përfundimtare.”

Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.18-2830/1
27.2.2024
Shkup

Ministër i Arsimit dhe
Shkencës,
Doc. Dr. **Jeton Shaqiri** d.v.